

Pershendetje z. Matlija,

Ne vijim te korrespondences suaj me Ministrine e sone , po ju kthejme pergjigje persa kerkuar:

1- Ne vitin 2006 Ministria e Mjedisit nepermjet fondit hollandez, ka mbeshtetur financiarisht Shoqaten “Per politika te reja te mbrojtjes se Mjedisit” ne zbatimin e projektit “Stop amiant”.

Koordinator I projektit Dr. Romeo Hanxhari

Ministria e Mjedisit nuk disponon ne arkivat e saj nje kopje elektronike te studimit, por ju mund te drejtoheni prane kesaj shoqate per te marre studimin e plote

Produkte te ketij projekti ishte nje studim lidhur me rrezikun e asbestit ne Shqiperi si dhe nje fushate informuese mbi rrezikun e ketij produkti. Nepermjet ketij studimi eshte bere nje vleresim i perafert I sasive te perdorur sipas dhjetvjecareve 1930-1990.

Sipas legjislacionit ne fuqi, qe prej vitit 1994, ndalohet perdorimi i asbestit si material termoizolues ne te gjitha llojet e ndertimeve per qellime banimi dhe perdorimi public. VKM nr. 447, date 19.09.1994, “Per ndalimin e perdorimit te asbestit si material termoizolues ne te gjitha llojet e ndertimit ”; Fletorja Zyrtare: Viti 1994, Nr 17, Faqe 791; Data e botimit: 20.12.1994.

Gjithashtu Vendimi Nr. 484, date 29.6.2016 “Per miratimin e rregullores per mbrojtjen e punemarrësve nga risqet lidhur me asbestin ne vendin e punës”, percakton kerkesat minimale per mbrojtjen e sigurisë dhe te shendetit te punemarrësve nga risqet qe krijohen ose mund te krijohen nga ekspozimi ndaj asbestit ne punë.Kërkesat e kesaj rregulloreje zbatohen per ndermarrjet, vendet e punës dhe veprimtarite ne te cilat punemarrësit jane te ekspozuar ose mund te ekspozohen ndaj asbestit gjate punës se tyre, duke percaktuar vlerat e lejuara dhe kerkesa te tjera te vecanta. Ky vendim ngarkon Ministrine e Shendetësisë, Ministrine e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe institucionet ne varësi te tyre per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi.

2- Ne vijim te komunikimit tone, mbi informacionin e kerkuar per subjektin “Turgut Ozal Education” me nr.NIPT K12125004O dhe “Turgut Ozal Education” me nr.NIPT K21406503S, nese eshte pajisur me Leje Mjedisore ju bejme me dije se:

Bazuar ne Ligjin Nr. 10 081, date 23.2.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise”, VKM Nr. 538, date 26.5.2009 “Per Licencat dhe Lejet qe trajtohen nga/apo nepermjet qendres kombetare te licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” dhe Ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.

Pas verifikimit ne sistemin elektronik te QKL-se (Regjistri Kombetar i Licencave dhe Lejeve), rezulton se subjekti "Turgut Ozal Education" me nr.NIPT K12125004O dhe "Turgut Ozal Education" me nr.NIPT K21406503S , nuk eshte i pajisur me Leje Mjedisore.

Per me tej ju bejme me dije, se me leje mjedisore sipas kuadrit ligjor, pajisen vetem aktivitetet qe gjate ushtrimit te aktivitetit nderhyjne me forma te ndryshme ndotjeje ose prekje ne mjedis. Ushtrimi i aktivitetit arsimor nuk perfshihet ne sektoret respektive